



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-152

Prishtinë, më 7 prill 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbahtur më 7 Prill 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Në fillim, kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për angazhimet dhe kontributin e dhënë, në veçanti me kërkesën e datës 12 mars 2013, gjë që ka rezultuar pozitivisht, meqë tani Kosova do të jetë vëzhguese në Asamblenë Parlamentare të NATO-s.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e amendamenteve në Kushtetutë, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovë Kosovës, u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 4 prill 2014.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2014,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2014.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 10 prill 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,

2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013,
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
12. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
13. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
14. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media,
15. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

* * *

Për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës së seancës plenare - Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, diskutuan: Jakup Krasniqi, Petar Miletiq, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit për pikën e rendit të ditës së seancës plenare - Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e hoqi nga rendi i ditës dhe nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion si Komision FunkSIONAL që t'i shqyrtojë amendamentet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pika shtesë:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”
Kryesia, pas diskutimit, projektligjin e lartpërmendur e radhiti si pikë të katërt në rendin e ditës për mbledhjen plenare të radhës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i propozim-kornizës afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015-2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2015-2017, mori këtë:

V e n d i m

1. Miratohet korniza afatmesme e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015-2017.

2. I rekomandohet Ministrisë së Financave që kornizën afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës ta përfshijë në Kornizën e Përgjithshme Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2015-2017.

2. Shqyrtimi i petitionit të qytetarëve të Rahovecit lidhur me fatin e Ukshin Hotit

Kryesia, pas diskutimit lidhur me petitionin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë petitionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit dhe Kryesisë së Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime lidhur për këtë çështje.

3. Njoftimi i dy deputetëve të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel prej 18-20 mars 2014

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të realizuar nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ahmet Isufi, dhe deputeti Arsim Bajrami, në Bruksel prej 18-20 mars 2014.

4. Njoftimi i deputetit Florin Krasniqi për heqje dorë nga paga mujore dhe kompensimet tjera materiale

Kryesia, pasi u njoftua nga deputeti Florin Krasniqi për heqje dorë nga paga mujore dhe kompensimet tjera materiale, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa e Administratës së Kuvendit se nga data 1 prill 2014, deputeti Florin Krasniqi ka hequr dorë nga paga mujore dhe kompensimet tjera materiale, të cilat i takojnë me status si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kryetar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale